# DËSHMI ARKIVI

**A-469358**

VERSIONI 2

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | VKM/ Fshati Vuno i Himarës deklarohet pasuri kulturore e paluajtshme ‘qendër historike’ - Shqiptarja.com |
| ADRESA | `https://shqiptarja.com/lajm/vkm-fshati-vuno-i-himares-deklarohet-pasuri-kulturore-e-paluajtshme-qender-historike` |
| BURIMI | shqiptarja.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 15:15:34 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 15:13:53 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `764e70db7ff217d5aeefcc78636afc98159fea543204f3122d47864af855f8f3` |
| TEKSTI | `6faf0af316b750b69973de56ca1b03d0ab627cfe66462d4c9c0f1622d6916f30` |
| PAMJA | `3af115ff296e857300c11935ed1438f0df31fa2f1e963a21ddb111ae901ad622` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `accad4129d4689723c0d2446bc7fd54ba3d2014f9b8e1f97a36081f22a43513d` |
| E MËPARSHMJA | `f8458ed448d4e6051e57ffe8e405d48433dfb3a8c82704e49d765d37a4f14fb5` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/accad4129d4689723c0d2446bc7fd54ba3d2014f9b8e1f97a36081f22a43513d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit
1

VIDEO/ Pronari i 'Mira Mare' qëllon me shpullë shefin e policisë së Krujës, sherr pasi bëri manovra të rrezikshme në rrugë! Ofendime me... palëve

Politikë

# VKM/ Fshati Vuno i Himarës deklarohet pasuri kulturore e paluajtshme 'qendër historike'

*Në vendimin e Këshillit të Ministrave është parashikuar edhe përcaktimi i zonës mbrojtëse dhe miratimi i planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e qendrës historike të fshatit Vuno.*


*Fshati Vuno i Himarës*




[Sh].com Redaksia
25 Shtator, 17:11 | **Përditësimi: 25 Shtator, 17:13**

f Share Tweet

A+ A-

Në mbledhjen e sotme të Këshillit të Ministrave është vendosur që fshati Vuno i Himarës të deklarohet pasuri kulturore e paluajtshme 'qendër historike'.

Në vendimin e Qeverisë parashikohet edhe përcaktimi i zonës mbrojtëse dhe miratimi i planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e qendrës historike të fshatit Vuno.

Vendimi do të hyjë menjëherë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare, ndërkohë që për zbatimin e tij ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Bashkia Himarë.

[Sh].com

LEXO EDHE:
**Grabitën 1.5 mln lekë në shtëpinë në Shelegar të Sarandës, videoja kur hajdutët kapërcejnë murin rrethues dhe largohen me çantën me para**

***Vendimi i Këshillit të Ministrave:***

*Vendim për deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme "qendër historike" të fshatit Vuno, përcaktimin e zonës mbrojtëse dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre*

*Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave "a" e "ç", të pikës 3, të nenit 9, të pikës 3, të nenit 62, dhe të pikës 1, të nenit 96, të ligjit nr.27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave*

*Vendosi:*

*1. Deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme "Qendër historike" të fshatit Vuno dhe përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj, sipas hartave të zonifikimit dhe koordinatave në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.*

*2. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e "Qendrës historike" të fshatit Vuno dhe të zonës mbrojtëse të saj, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.*

*3. Vendimi nr.30, datë 20.1.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e Qendrës Historike të fshatit Vuno dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj të zonës së mbrojtur përreth", shfuqizohet.*

*4. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për publikimin e hartave të "Qendrës historike" të fshatit Vuno dhe të zonës mbrojtëse të saj në Gjeoportalin Kombëtar.*

*5. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për regjistrimin e këtij vendimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kadastrën.*

*6. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Himarë për zbatimin e këtij vendimi.*

*Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".*

R.Xh/Shqiptarja.com

**TAG:** Vlore | himare | Vuno | pasuri kulturore | fletore zyrtare

**Sa e vlerësoni këtë artikull?** ★ ★ ★ ★ ★

LAJMET MË TË VLERËSUARA

**Komente** Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH com

**Sondazhi i ditës:** 22 Shtator, 16:08

**Arrestimet e fundit nga SPAK, a janë provë e pavarësisë nga politika?**

Po | Jo | Disi

## Lajme të tjera



**Report Tv siguron videon e eliminimit të Tanit të Ruzhdiut në Sarandë! 44-vjeçari ia mbath pasi qëllohet, autori me skafandër i vihet pas dhe i shkrep armën në kokë**

25 Shtator, 15:57



**Me dy armë dhe me skafandër në kokë, Report Tv siguron foton e autorëve në momentin kur eliminojnë 'Tanin e Rruzhdiut' në Sarandë**

25 Shtator, 14:07




**Hemodializa sërish privatit, anulohet tenderi 50 milionë euro! Agjencia e Prokurimit Publik: Gabime dhe mangësi në dokumente**

25 Shtator, 12:54



**Ndezi zjarr në oborr, flakët u përhapën dhe rrezikuan shtëpitë e fqinjëve, arrestohet 60-vjeçari në Vlorë (VIDEO)**

24 Shtator, 12:11



**Kadastra shkon derë më derë në Himarë, 235 banesa pa dokumentacion pronësie! Do të trajtohen edhe objektet pa kërkesë të**



**Mesazhet e Vlora Hysenit me Ergys Agasin, Spahiu në Report TV: Banalitet që dëmton imazhin e Shqipërisë në NATO!**

23 Shtator, 18:42

meparshme legalizimi
(VIDEO)
24 Shtator, 09:18




Vlora s'gjen 'qetësi', zjarr në zonën mbi Spitalin Rajonal! Flakët u afrohen banesave
23 Shtator, 15:48



Turisti gjerman thyen këmbën në Shtegun e Cezarit në Llogara, ndërhyjnë ekipet e emergjencës (VIDEO+FOTO)
23 Shtator, 12:59



Vendi s'gjen qetësi nga zjarret, vatër aktive në Parkun Natyror të Viroit në Gjirokastër! Vihen nën kontroll flakët në zonën mbi Spitalin Rajonal të Vlorës (VIDEO)
23 Shtator, 09:55




Sarandë/ Tentuan të kalonin drejt Greqisë 6 emigrantë, kapen pranë kufirit, 2 të arrestuar (VIDEO)
23 Shtator, 09:01



‘PD përgjegjëse për mos-dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve’- Kryetari i Ballit Kombëtar dega Vlorë vë në vështirësi Berishën: Pse s’ke bërë një muze për krimet e komunizmit?
22 Shtator, 19:52



Zjarr i përmasave të mëdha në fshatin Delisuf të Vlorës, flakët djegin sipërfaqe të mëdha me pemëtari dhe një stallë bagëtish
22 Shtator, 17:16



[Shqiptarja.com]

Kerko


© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.